



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja Urgjente të Legjislacionit të VII^{-të} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 16.02.2023, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBI.</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD^{-te} e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=ftHAhCBiDSM> : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje. Hap punimet për mbledhjen urgjente të Legjislacionit të VII^{-të} dhe propozon këtë rend dite:

Procesverbali

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e gjashtë (26) anëtarë të Kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojmë me mbledhjen,

Prezanton :

REND DITE

1. Miratimi i raportit të komisionit vlerësues për dëme nga vërshimet e muajit janar 2023 - Istog.

Kryesuesi i mbledhjes – fjalën ja kalon Kryetarit të Komunës që të sqaroj rreth kësaj pike.

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit dhe i falënderon për kontributin e tyre në mbledhje. Sqaron punën dhe ecurinë e Raportit të komisionit vlerësues për dëme nga vërshimet e muajit janar 2023 – Istog. fton zyrtarin përgjegjës z. Sekender Hasangjekaj për prezantim të raportit.

Udhëheqësi i Sektorit të Emergjencave z. Skender Hasangjekaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit të komisionit vlerësues për dëme nga vërshimet e muajit janar 2023 – Istog.

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, AAK dhe grupi i saj e përkrahin në parim këtë raport, po ndodh ka një here se ky raport dhe tjera materiale që po na vine ditën e mbledhjes dhe nuk po kemi mundësi ti shikojmë. Me rregull është që me i pas në raport dhe me i shikuar se çka po ndodhë, por në parim jemi për këtë raport që me i ndihmuar njerëzve qoftë në ekonomi familjare qoftë edhe në biznese. Kisha pasur dëshirë që këto ndihma të vine sa me shpejt se e pamë në javën e kaluar është votuar në kuvend një Ligj i cili pak “nëse ose,, me u mundu që sado pak familjeve me nevojë me ju dal në ndihme, sepse këto ndihma mund të vin edhe pas një viti, me e bë presionin edhe të qeveria e sa me shpejt me ju dal në ndihmë këtyre familjeve.

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, i ka shqetësimet pak a shumë si të Agronit kjo është bere dukuri që nuk po vjen materiali me kohë që ne me muajt me e shqyrtuar. LVV ju po thoni e keni përpara tash na erdh një material afër 20 faqe, ne këtë nuk mundemi këtu për këtu me e analizuar që me marr vendim a jemi për a jemi kundër, nuk po e dimë a po bëjmë mirë apo keq me këtë raport ne kemi marr vetëm dy faqe material ato kemi pasur kohë dhe kemi mundur me i analizuar edhe me shiku se çka po bëhet. Po me duket që është mungesë serioziteti këtu, normal që njerëzit kanë nevojë edhe presin ndihmën e institucionit që të gjithë e dimi këtu jemi kanë dhe i kemi par vërshimet e demet por po na privoni nga e drejta për me e pas mundësin me e marr një vendim të drejt po na dërgoni dy faqe material edhe unë po mendoj se ky nuk është raport, nuk mund ti thuash raport dy faqe material. Megjithatë ne se na ka ra në sy si LVV është infrastruktura 1,859,600.00 € a ka mundësi pak me na sqaruar çka po përfshihet të kjo shumë.

Kryetari i Komunës - ky raport do të dorëzohet para një ekipe që e ka themeluar Qeveria e Kosovës e që është ndërministrorë jopolitike po profesionale. Ata e kanë kompetencën ta analizojnë se sa është serioze sa jo nga komisionet tona që kanë qenë në teren nga dita e fillimit të reshjeve. Ky është raport informues për anëtarët e Kuvendit këtij raporti do ti bashkëngjiten të gjitha fotot dhe raporte nga vendi i ngjarjes për secilën familje apo dëm që kanë ndodhur. Sa i përket informimit besoj se secili prej jush e ka tash me këtë informacion përpara vetes. Të infrastruktura janë të dëmtuara 11 ura që duhet të ndërtohen të reja se janë të dëmtuara, dhe paraqesin rrezik për qytetaret që kalojnë nëpër to, ka rrugë të dëmtuara kanalizime po i përmendi disa se janë me të kushtueshme.

Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, shpresoj që me nuk do të ndodhin këso fatkeqësi dhe mos te kemi mbledhje të tilla. Unë besoj në këtë komision që ka dalë në teren dhe ka bërë vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësia natyrore jemi një nder komunat me më dëme të mëdha dhe për një periudhë shumë të shkurtër jemi goditur dy here. Edhe pse komisioni nuk është i licencuar për këto fatkeqësi por e kanë cilësuar një dëm e që për komunën tonë është një dëm i konsiderueshëm ashtu që komuna jonë nuk mundet këtë shumë ta përballojë. Falënderoj Kryetarin dhe ekipin e tij që kanë qenë në nivel detyre dhe i kanë përballuar këtë gjendje bashkë me qytetaret.

Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, nuk deshta të përfshihem por kam disa vërejtje për kryesuesin e atij komisioni që po fol. Pse raporti me u vlerësuar nga disa persona që nuk janë të certifikuar. Ne nuk jemi që mos me u ndihmuar dhe me u kompensuar qytetaret që kanë pas dëme.

Ne nuk e dimi a me votu për apo kundër mu me vjen raporti qitash, nuk e di as kush ka aplikuar as nuk është pranuar as kush është refuzuar, nuk kam kohë unë këtë për dhjetë minuta me e vlerësuar, nuk e kam asgjë personale as me ty as me kryetarin por e kam që ky raport mos me u kthyer si raportet e kaluara.

Skender Hasangjekaj - komisioni nuk është i certifikuar por janë njerëz profesional, inxhinier i makinerisë, inxhinier i ndërtimitarisë, ekonomis etj. Nuk janë të certifikuar me i plotësuar formularët.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kjo situatë e cila na ka ardhur ne është fatkeqësi natyrore e nuk është hera e parë e as e dyta kjo nuk vjen me vullnet por nga natyra, na vjen keq për qytetaret që kanë pasur dëme nga kjo fatkeqësi. Personalisht si individ e përgëzoj kryetarin dhe komisionin që kanë punuar në këtë drejtim mjaftueshme në të dyja rastet. Siç tha edhe Agroni jam për me ju ndihmuar sepse qytetaret sytë i kanë nga ne. Kam një vërejtje të vogël mungesa e këtij raporti por na sqaruar pse.

Hajrush Shoshi - përshëndet të gjithë të pranishmit, e përgëzoj komisionin për këtë raport mirë po një gjë është dashur ta kuptojmë të gjithë ne sepse ky është vetëm një raport për kërkese nuk janë këto mjete as të ndara as të afuara që shpresoj shumë që kemi me marrë këtë shumë. Të shkoj kërkese në ministri dhe mos të mbesim mbrapa.

Florin Dreshaj - LVV voton për këtë raport edhe pse në mënyrë qorre nuk kemi parë ne asgjë, ka dyshime edhe për fryrje të shifrave, edhe që mund të keq përdoret diçka, duke u bazuar se edhe me herët kur fryke era, por për hir të qytetarëve në mënyrë qorre e votojmë këtë.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka edhe dikush që dëshiron ta marr fjalën rreth këtij raporti, pasi që nuk ka dikush tjetër diçka atëherë:

Hedh në votim

Kushte është për:

Miratohet unanim .

Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të Kuvendit.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.
Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:45.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**



**Kryesues i Kuvendit,
Enver Rugova**